

Policia e Kosovës sulmohet sërish në veri me mjete shpërthyes



16/04/2022 09:42



Policia e Kosovës është sulmuar sot sërish në veri të Kosovës.

Rasti ka ndodhur më saktësisht në Sharpej të Jarinjës ku kanë ndodhur dy shpërthime nga mjete të dyshuara piroteknike, shkruan [lajmi.net](#).

Shpërthimet kanë ndodhur afër veturës së policisë e cila ishte në një pikë statike ku policia ishte e përqendruar në parandalim të kontrabandës në atë zonë.

“Nga shikimi i vendit të ngjarjes është vërejtur se në xhamin e veturës policore ka mbetur një copë letre (dyshohet mbështjellës i mjeteve piroteknike). Ngjarja ka ndodhur në një pjesë që është afër territorit të Serbisë dhe dyshimi i bazuar është se këto mjete janë hedhur nga territori i Serbisë. Policia ka qenë duke monitoruar një rrugë ilegale të mbyllur kohë më parë dhe e cila përdorej për kontrabandë të mallrave.”, thuhet në komunikatën e policisë.

Nga ky rast nuk ka të lënduar e as dëme materiale.

Policia po vazhdon aktivitetet e saj për parandalimin e akteve kriminale ndërkufitare në veri të Kosovës dhe për ofrimin e sigurisë për të gjithë.

Kjo është komunikata e plotë e policisë:

Sot, më 16.04.2022, rreth orës 03:10, në Sharpej të Jarinjës, kanë ndodhur dy shpërthime (dyshohet nga mjete piroteknike). Shpërthimet kanë ndodhur afër veturës së policisë e cila ishte në një pikë statike ku policia ishte e përqendruar në parandalim të kontrabandës në atë zonë.

Nga shikimi i vendit të ngjarjes është vërejtur se në xhamin e veturës policore ka mbetur një copë letre (dyshohet mbështjellës i mjeteve piroteknike). Ngjarja ka ndodhur në një pjesë që është afër territorit të Serbisë dhe dyshimi i bazuar është se këto mjete janë hedhur nga territori i Serbisë. Policia ka qenë duke monitoruar një rrugë ilegale të mbyllur kohë më parë dhe e cila përdorej për kontrabandë të mallrave.

Nga ky rast, nuk ka persona të lënduar as dëme materiale. Policia është duke e trajtuar rastin dhe do të vazhdojë aktivitete operative për të parandaluar aktet kriminale trans-kufitare në atë zonë dhe ofrimin e sigurisë për të gjithë. [/Lajmi.net/](#)



Artikuj të ngjashëm



April 16, 2022

Shoqëroi mikun në Obiliq për ta marrë një eskavator, vushtrriasi përfundon...



April 16, 2022

Mediumi i Vuçiqit thotë se shefi i tyre do t'i reagojë...



April 16, 2022

Kryeministri bullgar: Nëse s'ka stabilitet në Ballkan, s'kemi arritur asgjë...




April 16, 2022

Policia e Kosovës ende pa sigurime shëndetësore – mbi 400 të...



April 16, 2022

Deputeti suedez e krahason Mitrovicën me Berlinin e dikurshëm



April 16, 2022

Greqia goditet nga një termet i fortë